



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr.201, datë 02.10.2019

PËR
KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...}
PËR NË FORMIMIN FILLESTAR PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQATAR,
NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 02.10.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatori z.Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin kandidatës znj. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2019-2020,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Znj. {...} është candidate për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në kushtet kur:

a) është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të Raportit të Vlerësimit Përfundimtar të datës 01.04.2019, se plotëson kriteret e pranimit në formimin fillestar për magistrat sipas nenit 28 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji i Statusit);

b) ka marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas nenit 31 të Ligjit të Statusit, dhe është në listën e renditjes së kandidatëve fitues në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, të miratuar me Vendimin nr.11, datë 15.05.2019, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjell pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr.1588 prot., datë 27.05.2019 (protokolluar me nr. 2898 prot., datë 27.05.2019).

2. Me Vendimin nr.83, datë 05.06.2019, mbështetur në nenin 32 të Ligjit të Statusit, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për

emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës për kandidatët për magjistratë, profili gjyqtarë, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...} si relator u caktua z.Alban Toro.

3. Më datë 10.06.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatja znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua : - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditror, kandidatja znj. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidatja nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 14.06.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidates znj. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidatja znj. {...}, depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datat 25.06.2019 dhe 28.06.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për znj. {...}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjell për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, pas kërimit dhe dhënies nga kandidatja, në rrugë elektronike, të dhënave të punësimit, më datë 27.06.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion nga subjektet shtetërorë dhe privatë që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidatës znj. {...}, të cilët kanë përcjell për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

10. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten {...}, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 23.09.2019, relatori e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

11. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen me datë 27.09.2019 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin ose skualifikimin e kandidatës {...} për në formimin fillestar për magistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE LIGJORE TË KANDIDIMIT

A. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës, sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit

1. Sa i përket kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, për pranimin në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës, përfshirë edhe për kandidaten {...}, si dhe më lart u parashtrua, vlerësimi për plotësimin e tyre është bërë, në momentin e kandidimit, nga ana e Shkollës së Magjistraturës, bazuar kjo në nenin 30¹ ("Kandidimi

¹ "1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti.

2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit.

3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji.

4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij.

dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve”) të Ligjit të Statusit. Në përfundim të vlerësimit, Shkolla ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat, ku pas komenteve të Këshillit, më datë 01.04.2019, Shkolla ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare Raportin e Vlerësimit Përfundimtar, përfshirë dhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidatja {...}.

2. Gjithsesi, për kandidaten {...} u verifikuan sërish disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës, përcaktuar në nenin 28 të Ligjit të Statusit.

2.1 Për këtë është mbajtur në konsideratë diferenca kohore mes momentit të aplikimit të kandidatëve (Shkurt 2019), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve nga ana e tyre (1 Prill 2019), si dhe momentit aktual, kur Këshilli duhet të shprehet për kualifikimin ose jo të kandidatëve për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë rezultuar fitues në provimin e pranimit (Shtator 2019). Dhe po ashtu, nga ana tjetër, është mbajtur në konsideratë dhe fakti se shumica e kriterëve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990).

2.2 Gjithashtu, për këtë është mbajtur në konsideratë se një verifikim i tillë është detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 32 (“Verifikimi i pasurisë dhe figurës”)², pika 4,

5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe aktet nënligjore përkatëse”.

² 1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë dhe figurës.

2. Brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, sipas nenit 31, të këtij ligji, për secilin kandidat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.

3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre.

4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet në Shkollën e Magjistraturës kur:

shkronja “c”, të Ligjit të Statusit, sipas të cilit Këshilli ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e çdo shkaku përjashtues (të parashikuar nga ligji) nga kandidimi për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Përveç kësaj, është mbajtur në konsideratë se detyrimi i Këshillit për verifikimin e kriterëve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra ato sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, është një detyrim konstant i Këshillit qoftë në momentin e emërimit të diplomuarve për magistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre si magistrat (gjyqtar), referuar për këtë në nenet 35, 64 dhe 66 të Ligjit të Statusit.

3. Konkretisht, për kandidaten {...} u verifikua sërish kriteri:

a) i pasjes së zotësisë së plotë për të vepruar, ku për këtë nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) i pasjes së shtetësisë shqiptare, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, është depozituar dokumenti “Pasaportë”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 21.05.2010 ku pasqyrohet përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”. Ndërkohë, gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidatë. Përkundrazi, nga verifikimi i bërë, më datë 01.10.2019, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidatja vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;

b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";

c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit.

5. Deri në datën 5 shtator të çdo viti, Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

6. Kandidatët kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave, brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për ankimin, brenda dy javëve nga paraqitja e tij.

7. Pas përfundimit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, Këshillat miratojnë dhe publikojnë në fund të muajit shtator të çdo viti, listën përfundimtare të kandidatëve magistratë, që pranohen në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar trejeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar sipas nenit 29 dhe duke respektuar me përpikëri renditjen e kandidatëve në listën e parashikuar në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji.

c) i gjendjes gjyqësore, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kjo e fundit ka kryer verifikim në regjistrin gjyqësor elektronik të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) duke printuar në letër Certifikatë Elektronike datë 08.03.2019: Ndërkohë, gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidates, u administrua Shkresa nr.V-2125/1 prot., datë 04.07.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve kandidatja nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë;

ç) i disiplinës në punë, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës është depozituar Vërtetimi datë 11.02.2019, i Këshillit të Qarkut Korçë, ndërkohë që gjatë verifikimit u administrua Shkresa nr. 3481/1 prot., datë 04.07.2019, e Këshillit të Qarkut Korçë. Sipas këtyre dokumenteve kandidatja nuk është e larguar nga puna për shkaqe disiplinore apo ajo nuk ka masë disiplinore në fuqi

d) i qenies bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim në të cilën deklaron se nuk ka qenë bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete. Ndërkohë, gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidates bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete.

4. Për kriteret e tjera të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, të cilat janë verifikuar nga kjo e fundit si organi kompetent, u konsiderua vlerësimi i bërë prej saj dhe konkretisht për:

a) pasjen e kriterit arsimor. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidatja ka depozituar dokumentin “Diplomë - E Nivelit të Dytë në Drejtësi ”, me nr. 3701, datë 05.07.2001, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, si dhe Vërtetim Notash 02.07.2001, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë;

b) pasjen e përvojës profesionale. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidatja ka depozituar dokumentin “Librezë Punë”, sipas të cilit kandidatja ka përvojë profesionale aktive me kohë të plotë në administratën publike, konkretisht “juriste”, pranë Këshillit të Qarkut Korçë, për periudhën 25 maj 2002 - 13 korrik 2018.

c) mos anëtarësinë në parti politike në kohën e kandidimit. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim në të cilën deklaron se nuk është anëtare e ndonjë partie politike;

ç) mosqenien anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim në të cilën deklaron se nuk ka qenë anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990. Gjithsesi, për këtë kriter, në funksion të verifikimit të figurës së kandidates, qoftë edhe sa i përket saktësisë së vetëdeklarimit të saj,

gjatë verifikimit u kërkua informacion nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit (siç do të përshkruhet më poshtë).

B. Për kriterin e pasurisë sipas nenit 32 të Ligjit të Statusit

1. Për kandidaten {...} u verifikua edhe kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 25/27 prot., datë 19.08.2019.

2.1 Sipas Raportit të ILDKPKI-së, kandidatja {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë dhe interesave.

2.2 Po ashtu, sipas Raportit të ILDKPKI-së, kjo e fundit ka kryer kontrollin e plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidatja {...}, duke konkluduar se për kandidaten :

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...} u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

3.1 Në informacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, dërguar me Shkresën nr. 12592/1 prot., datë 08.07.2019, për kandidaten {...} nuk jepen të dhëna për aktivitete tregtare.

3.2 Në informacionin e Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave, dërguar me Shkresën nr. 16911/1 prot., datë 12.07.2019, për kandidaten {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

4. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'i kërkuar ILDKPKI-së bërjen e një kontrolli shtesë.

5. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga formimi fillestar për në Shkollën e Magjistraturës sa i përket kriterit të pasurisë. Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkuara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidatja ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e saj;
- ç) deklarimi nga kandidatja i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

C. Për kriterin e figurës sipas nenit 32 të Ligjit të Statusit

1. Për kandidaten {...} u verifikua edhe kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, u kërkuar raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk është ngritur ende.

3. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidates {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare ose në aktivitete të kundërligjshme.

4. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, asaj iu kërkuar dhe ajo plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 19.06.2019, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të dhënave të saj në lidhje me figurën dhe integritetin.

4.1 Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjell në Këshill, me Shkresën nr. 1782/222 prot., datë 02.09.2019, Vendimin “Për rezultatet e verifikimit”, sipas të cilit është vlerësuar se *“Subjekti deklarues {...}, kandidatë për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

4.2. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 5655/1 prot., datë 19.08.2019, ka dërguar në Këshill të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidaten {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile. Sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, për kandidaten {...}, është bërë me dije se “korrigjimi i përbërësit të gjendjes civile, emrit të nënës, nga “Syzana” në “Suzana”.

4.2.1 Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidatja {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Për pasojë, u vlerësua që kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme, duke iu kërkuar kjo përmes Shkresës nr.3524/3 prot., datë 27.08.2019. Vlen të theksohet se nga Prokuroria e Përgjithshme ende nuk ishte dërguar Vendimi “Për rezultatet e verifikimit”, përcjell me Shkresën nr. 1782/222 prot., datë 02.09.2019.

4.2.2 Në përgjigje të kërkesës së Këshillit për verifikim shtesë, Prokuroria e Përgjithshme, me Shkresën nr. 3524/5 prot., datë 27.09.2019, informon Këshillin se pas kryerjes së verifikimeve konstaton se, referuar Vendimit “Për rezultatet e verifikimit” për subjektin {...}, rezulton se në të jenë pasqyruar edhe veprimet e korrigjimit të përbërësit të gjendjes civile, në rubrikën e emrit të nënës, nga “Syzana” në “Suzana”. Në këto kushte, Prokuroria e Përgjithshme ka ri konfirmuar se ky subjekt nuk përfshihet në përcaktimet e nenit 2 të Ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

5. Gjithashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, asaj iu kërkuua dhe ajo plotësoi dhe depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 18.06.2019, edhe formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

5.1 Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjell në Këshill, me Shkresën nr. 3571/1 prot., datë 24.07.2019, Vendimin nr.462 datë 18.07.2019, me të cilin është vendosur se: *“Për znj. {...}, kandidate për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, nuk rezultojnë të dhëna në dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.*

6. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga

formimi fillestar për në Shkollën e Magjistraturës sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkuara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;
- c) për kandidaten nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- d) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtore, informatore ose agjente e shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidaten nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e saj mbi të cilën të ngrihen dyshime për pranueshmërinë e saj për në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës.

III. KONKLUSIONE

1. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

2. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja përmbush këto kritere, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020.

PËR KETO ARSYE

Mbështetur në nenin 32, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në shkronjën “a”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit

të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2019-2020.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR